

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “MED-Group” SH.P.K.

KREU I

THEMELIMI, EMRI, FORMA LIGJORE, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA

NENI 1

THEMELIMI

Sot në datën 10.10.2023, **znj. Marinela RUKIA**, shtetase shqiptare, lindur në Tepelenë më 28.04.1995 dhe banuese në Tiranë, Shqipëri, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, ka vendosur të themelojë, në Tiranë, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, dt 14/4/2008 “Për Shoqëritë Tregtare dhe tregëtarët” dhe ligjet e tjera në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

NENI 2

EMRI, FORMA LIGJORE

Emri i shoqërisë është “**MED-Group**” Sh.p.k;

Shoqëria është themeluar si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, si person juridik, në përputhje me legjislacionin shqiptar;

Shoqëria fiton personalitet juridik me rregjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit; Aktiviteti i shoqërisë do të zhvillohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe dispozitave të paraqitura në këtë Akt Themelimi dhe Statut.

NENI 3

SELIA

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “**MED-Group**” Sh.p.k. do ta ketë selinë e saj në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Margarita Tutulani”, Ndërtesa nr. 10, Hyrja 4, Kati 2, Apartamenti 6.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “**MED-Group**” Sh.p.k. do të ketë objektin si mëposhtë:

Konsulencë Ligjore, Mjekësore, Financiare, Konsulencë në fushën e legjislacionit shëndetësor dhe sigurimeve shëndetësore. Konsulencë për shërbime dhe dieta spitalore. Trajnime për Infeksionet Spitalore. Konsulencë për Sigurimin Teknik dhe Sigurinë në Punë, Mjekësia e Punës dhe Aksidentet në Punë, Sondazhe, Studime, Kërkime dhe Shkrim Projektesh në fusha të ndryshme.



Konsulencë e Përgjithshme në Industritë: Mjekësi dhe Shëndet Publik, Inxhinieri Mjedis dhe Energjitikë, Ekonomi Transportesh, Kimi Ushqimore, Mjedis, Energji, Telekomunikacion, Bujqësi/Prodhime Bujqësore, Hoteleri – Turizëm, Ushqim, Aviacion, Ndërtim, Mallra të Konsumit, Financa, Prodhime Industriale, Inspektim/Mirëmbajtje paisjesh mjekësore dhe ashensorësh, Shkenca Natyrore, Logjistikë Miniera, Naftë & Gaz në Sektorin Publik dhe Privat. Konsulencë Operacionale, Plan Biznesi, Menaxhim dhe Këshillim.
Konsultim Strategjie, Teknologjie dhe Zhvillim Strategjie Digital Marketing.

Tregëti për paisje mjekësore, paisje dentare, produkte farmaceutike, mjekësore, estetike dhe kozmetike. Import/Eksport i pajisjeve dhe materialeve elektromjekësore, laboratorike, spitalore, të ndryshme, shitjen e tyre me shumicë dhe pakicë, mirëmbajtjen dhe servisin e tyre.

Tregëti për materiale ndërtimi dhe pjesë të ndryshme këmbimi, goma, vaj, filtra, bateri, etj.

Grumbullim, Pëpunim, Transportim dhe Evadim Mbetjesh Urbane dhe Mbetje të Rrezikshme Spitalore, Riciklim Materialeve të ndryshme.

Konsulencë për paisjen me Leje Mjedisore. Shërbime Dezinfektimi Dezinsektimi dhe Deratizimi (DDD), Shërbime dhe konsulencë në fushën Spitalore dhe të Mjedisit/Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Shërbime/Produkte pastrimi ambjentesh industriale dhe civile, Shërbime Lavanterie/Hoteleri (Pastrim Kimik). Tregëti Mobiljesh dhe Tapiceri.

Shërbime/Produkte Rrobaqepësie (Qepje artikujsh të ndryshëm/Riparime/Materiale për kurse rrobaqepësie).

Shërbime IT, Programim, Zhvillim Web dhe Mobile. Fushata Reklamuese dhe Marketing. Krijim, prodhim dhe mirëmbajtje e faqeve të internetit. Promovimin e Shitjeve dhe Eventeve, Realizimin e Seminareve, Konferencave dhe Aktiviteteve, Panaire, Shërbim Katering, Produkte Ushqimore dhe Kancelari.

Shërbime shitje/blerje (bar dhe restorante)

Import – Eksport/Shumicë – Pakicë/Magazinim Mallrash

Zhvillimi i pasurive të paluajtshme, ndërtim, rikonstruksion, investime në infrastrukturë dhe në fushën e ndërtimeve civile dhe industriale. (aktivitete të tjera sa më sipër: shitblerje banesash, lokale, dyqane, zyra, magazina, garazhe, dhënie e ambjentëve me qera, Airbnb, Booking) – Zbatimin e ndërtimeve civile dhe urbane.

Shërbime dhe Produkte Hidraulike, Elektrike, Elektronike, Lyerje, Patinim dhe Suvatim të çdo lloji objekti.

Shërbime në fushën energjetike (projektimin, ndërtimin, instalimin, përdorimin, vënia në punë e centraleve të prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, të çdo tipi e lloji, në mënyrë ilustruese por jo shteruese.



Tregtim dhe mirëmbajtjen e të gjitha llojeve të makinerive elektromekanike, ajër të kondicionuar, makineri termohidraulike, tregtimin e materialeve të ndërtimit si dhe ndërtimin e marketingun e makinerive të teknologjisë së lartë, elektrike dhe pajisjet elektronike. Kryerja e studimeve për ngrohje, gaz, pajisje hidraulike dhe instalimet elektrike. Ekspertizë në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme.

Për këtë qëllim, Shoqëria mund të ushtrojë veprimtarinë e saj në Shqipëri dhe jashtë saj e të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës, të ngjashëm, plotësues apo të dobishëm për përmbushjen e objektit të saj.

Për realizimin e objektit të aktivitetit saj, shoqëria mund të:

- a) zotërojë pjesëmarrje në shoqëri dhe sipërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, që kryejnë aktivitete të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose të subjekteve pjesëmarrëse;
- b) Të importojë, eksportojë, prodhojë, tregtojë me shumicë e pakicë, mallra, produkte, makineri dhe pajisje të nevojshme, të lidhura, plotësuese apo ndihmëse për ushtrimin e aktiviteteve objekt veprimtarie;
- c) kryejë të gjitha veprimet e nevojshme apo të dobishme me qëllim apo në lidhje me, përfshirë por pa u kufizuar në dhënien e garancive reale dhe/ose personale për detyrimet e veta apo të të tretëve, veprime juridike me pasuri të luajtshme, të paluajtshme, përfshirë por pa u kufizuar në: të blejë, shesë, marrë dhe/ose japë me qira, në përdorim, me uzufrukt apo shfrytëzim pasuri të luajtshme ose të paluajtshme, etj., të marrë dhe japë hua, si dhe çdo veprimtari tjetër tregtare dhe veprime të tjera të lidhura me objektin e aktivitetit të saj apo që mundësojnë një përdorim më të mirë të strukturave dhe/ose burimeve të veta apo të shoqërive dhe sipërmarrjeve në të cilat zotëron.

Shoqëria brenda hapësirave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryej çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë së saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive të tjera, krijimin e sipërmarrjeve të reja dhe pjesëmarrjen në sipërmarrje të tjera, brenda dhe jashtë vendit. Shoqëria mund të kryej edhe aktivitete të tjera shtesë, me qëllim përmbushjen e veprimtarisë të saj kryesore në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Çdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të Shoqërisë.

NENI 5 KOHËZGJATJA

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar themelohet për të ushtruar veprimtarinë e saj për një periudhë të papërcaktuar. Shoqëria mund të mbarojë aktivitetin e saj për shkaqe e arsye të ndryshme, dhe kjo do të bëhet në përputhje me normat e Statutit dhe Legjislacionit në fuqi.



KREU II

NENI 6

KAPITALI FILLESTAR I SHOQËRISË

Kapitali bazë i themelimit të Shoqërisë është 1000 lekë, zotërues i një (1) kuote me vlerë të përgjithshme 1000 lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar; e cila zotërohet nga ortakja e vetme e shoqërisë:

Marinela Rukia, lindur në Tepelenë dhe banuese në Tiranë, identifikuar me mjetin e identifikimit me numër **J55428020G**, zotërues i një (1) kuote me vlerë 1000 lekë që përbën **100%** të kapitalit themeltar.

Kuotat e shoqërisë janë lirisht të transferueshme, sipas legjislacionit në fuqi;

Ortakja e shoqërisë është përgjegjëse ndaj Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar për të gjitha detyrimet e marra përsipër dhe përgjigjet për detyrimet ndaj të tretëve deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

KREU III

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

NENI 7

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Asambleja e përgjithshme, e thirrur ligjërisht dhe e mbledhur në mënyrë të rregullt, është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë. Vendimet e marra prej saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dispozitat e këtij Akti themelimi e Statuti, janë të detyrueshme për tu zbatuar e ndjekur.

Asambleja e përgjithshme ka këto funksione e përgjegjësi:

- përcaktimin e politikave tregtare dhe ekonomike të shoqërisë dhe mbikqyrjen e zbatimit të tyre nga administratori i shoqërisë, përfshirë raportimet financiare
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve
- emërimin dhe shkarkimin e likujduesit dhe ekspertit kontabël të autorizuar
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecures së veprimtarisë të përgatitura nga administratori
- vendimin për ndryshime në këtë akt themelimi dhe statut
- vendimin për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit
- vendimin për shpërndarjen e fitimeve dhe dividendëve
- vendimin për pjesëtimin e kuotave
- vendimin për krijimin e marrëveshjeve që lidhen me shitjen, blerjen, pjesëmarrjen dhe investimin në projekte ekzistuese e të reja
- vendimin për dhënien dhe marrjen e huasë për financim biznesi
- vendimin për blerje pasurie të paluajtshme
- vendimin për bllokimin dhe lënien peng të pasurive të paluajtshme pranë ZRPP
- marrjen e vendimit për prishjen dhe likuidimin e shoqërisë

- miratimin e mbikqyrjes dhe ndjekjes së zbatimit të buxhetit, apo dhe shpenzimeve të paparashikuara në buxhet
- marrjen e çdo vendimi tjetër të parashikuar nga ligji shqiptar

NENI 8

MBLEDHJET E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

- (1) Administratorët thërrasin Asamblenë e Përgjithshme dhe, me kërkesën e ortakëve sipas Nenit 84 të Ligjit, do të procedojnë me thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme;
- (2) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (email) drejtuar çdo ortaku. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë;
- (3) Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë;
- (4) Asambleja e përgjithshme thirret nga administratori ose nga një a më shumë ortakë që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të shoqërisë;
- (5) Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë shumicë të zakonshme, asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave;
- (6) Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë shumicë të kualifikuar, asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë apo me mjete elektronike;
- (7) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më sipër, Asambleja mbledhet përsëri, jo më vonë se 30 ditë, me të njetin rend dite;

NENI 9

MANDATI, TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

- (1) Shoqëria administrohet nga 1 (një) administrator i emëruar nga Asambleja e Përgjithshme;
- (2) Shoqëria do të administrohet nga znj. Marinela Rukia, shtetase shqiptare, lindur në Tepelenë më 28.04.1995 dhe banuese në Tiranë, identifikuar me nr. karte identiteti

032719668 dhe nr. personal J55428020G, në përputhje me Statutin dhe dispozitat respektive të Ligjit 9901 "Për Shoqëritë Tregtare dhe tregëtarët";

- (3) Administratori është i zgjedhur për 5 vjet me të drejtë rizgjedhjeje, bazuar në vendimin e Asamblesë së përgjithshme që vendos për revokimin, rinovimin apo emërimin e administratorit të ri;
- (4) Shoqëria prezantohet ndaj të tretëve nëpërmjet administratorit;
- (5) Administratori ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:
 - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - f) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut;
- (6) Administratori mund të autorizojë, nëpërmjet një procedure, një person të tretë për të përfaqësuar shoqërinë;
- (7) Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e mospërmbljes së përgjegjësive të parashikuara në statut dhe legjislacionin në fuqi.

KREU IV

VITI FINANCIAR – SHPËRNDARJA E FITIMEVE

NENI 10

VITI FINANCIAR

Me përjashtim të vitit të parë të aktivitetit, që fillon nga data e themelimit të shoqërisë, viti financiar fillon më datën 1 janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

NENI 11

SHPËRNDARJA E FITIMEVE

1. Pas miratimit të Pasqyrave Financiare vjetore, Asambleja e Përgjithshme vendos në lidhje me shpërndarjen ose jo të fitimit, nëse ka.
2. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse, pas pagimit të dividendit:
 - a. Aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj
 - b. Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

KREU V

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

NENI 12

Prishja dhe likujdimi i shoqërisë do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

KREU VI

BAZA LIGJORE

1. Rregullat për funksionimin dhe drejtimin e shoqërisë janë përcaktuar në këtë statut dhe akt themelimi si dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi;
2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut e akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Ky dokument përpilohet në katër kopje, duke patur secila kopje fuqi të plotë ligjore.
Ortaku nënshkruan me vullnet të plotë këtë akt me përmbajtjen e mësipërme.

ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË “**MED-Group**” SHPK

Marinela Rukia

